



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtinë, më 8 prill 2024

THIRRJE PUBLIKE

PËRKRAHJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE

PËR SHËRBIME SOCIALE E FAMILJARE

Për ofrimin e përkrahjes financiare publike projekteve të organizatave joqeveritare (OJQ-ve), që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për individët, familjet dhe grupet e cënueshme, e në nevojë, në Kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.

Drejtoria e Mirëqenies Sociale, e Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, u bënë thirrje të gjitha organizatave joqeveritare (OJQ), të regjistruara në Republikën e Kosovës sipas dispozitave ligjore të aplikueshme në Kosovë, fushëveprimi i të cilave është i fokusuar në fushën e mbrojtjes sociale, ofrimin e shërbimeve sociale e familjare, hulumtimeve, analizave të lidhura me fushën e shërbimeve sociale, ngritjen e kapaciteteve profesionale të resurseve njerëzore e institucionale, hartimin e dokumenteve strategjike, përkrahjen e individëve fëmijë dhe të rritur, familjeve dhe grupeve të rrezikuara dhe në nevojë për shërbime sociale profesionale e familjare si në vijim:

- Fëmijët pa përkujdesje prindërore e familjare, në rrezik për humbjen e përkujdesit prindëror;
- Fëmijë të keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, të bullizuar (ngacmuar), stigmatizuar, dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktimat të krimit kibernetik;
- Të gjitha grupimet e personave (fëmijë, të rritur) me aftësi të kufizuara;
- Viktima e krimit, dhunës në familje, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimeve seksuale;
- Të mbijetuarat e dhunës në familje – riintegrimi dhe fuqizimi;
- Prindërit vetëshqyes në gjendje të nevojës sociale;
- Vajzat dhe gratë e marginalizuara në aspektin ekonomik dhe social në viset rurale dhe urbane;

- Fëmijë në forma të rënda të punës;
- Fëmijët me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur;
- Të moshuarit në nevojë për përkujdesje familjare e sociale;
- Të miturit në martesat e hershme, vajzave dhe djemve, parandalimi dhe vetëdijesimi;
- Komunitetet joshumicë me përkatësi etnike, fuqizimi i kujdesit familjar dhe përfshirja sociale;
- Fëmijët me nevoja të veçanta edukative- arsimore – nevoja logopedike;
- Komuniteti LGBTI+ në nevojë për përkrahje me shërbime profesionale e sociale;
- Abuzuesit e substancave psiko-aktive;
- Familjet në kushte të pafavorshme socio-ekonomike;
- Veteranët dhe invalidët e luftës.

OJQ-të (Organizatat Joqeveritare) në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektet e tyre për fushat e përcaktuara si në vijim:

1.0. Për personat me aftësi të kufizuara, projektet e te cilave duhet të jenë të dizajnuara të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien psiko-fizike, sociale e familjare. Projektet duhet jenë të fokusuar në fushat si në vijim:

- I. Të cilat ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta sipas nevojave të secilës prej kategorive të personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund t'i përballojnë koston e këtyre shërbimeve;
- II. Projektet të cilat mbështesin prindërit/ kujdestarët apo familjet e tyre për shkathtësi dhe kujdes adekuat ndaj nevojave të personave me aftësi të kufizuara;
- III. Projekte të cilat kanë për qëllim fuqizimin për jetë të pavarur dhe përfshirje sociale e pjesëtarëve të secilës prej kategorive të personave me aftësi të kufizuara;
- IV. Projekte që ofrojnë shërbime direkte për ngritjen e aftësive dhe shkathtësive profesionale;
- V. Projekte që ofrojnë shërbime mobile për përkujdesje sociale e familjare;
- VI. Projektet të cilat mundësojnë aktivitetet dhe hapësira për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve me aftësi kufizuara.

2.0. - Fëmijët pa përkujdesje prindërore apo në rrezik për humbjen e kujdesit prindëror, dhe të rriturit pa përkujdesje familjare. Të gjitha projektet duhet të jenë të dizajnuara që të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë në plotësimin e nevojave e mirëqenies së tyre. Këto projekte duhet të jenë të fokusuar në fushat si në vijim:

- I. Projekte që ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë të shërbimeve për fëmijët, familjet në strehimin rezidencial, strehimin familjar, brenda dhe jashtë familjes, përkrahjen psiko-sociale dhe të aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu ngritjen e

kapaciteteve profesionale te resurseve njerëzore e institucionale, duke përfshirë edhe ndarjen e praktikave të mira apo sfiduese, vendore e ndërkombëtare, për ofrimin e shërbimeve të lartcekura;

- II. Projektet që ofrojnë shërbime për të rriturit pa përkujdesje familjare, të cilat kanë për qëllim përkrahjen dhe plotësimin e nevojave;
- III. Projekte të ndryshme që synojnë dhe kanë për qëllim parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, keqtrajtimit dhe kërkim-lëmshës, punën e rëndë, ofrimin e shërbimeve direkte për fëmijët viktima potenciale dhe të trafikimit;
- IV. Projekte që kanë për qëllim fuqizimin e prindërimit aktiv dhe pavarësisë nga dukuritë negative.

3.0. Fëmijë të abuzuar dhe keqtrajtuar, fëmijë dhe të rritur në situatë rruge, fëmijë të bullizuar (ngacmuar), stigmatizuar dhunën në mes bashkëmoshatarëve, të rrezikuar dhe viktima të krimit kibernetik;

- I. Projekte që për qëllim kanë përkrahjen e drejtpërdrejtë, individuale dhe grupore, dhe fuqizimin e fëmijëve në ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen nga format e ndryshme të dhunës për të drejtat dhe respektimin e të drejtave të tyre;
- II. Projekte që ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë të shërbimeve përmes strehimit, përkrahjes psiko-sociale, aktiviteteve ditore dhe rekreative;
- III. Projekte që kanë për qëllim përkrahjen psiko sociale dhe familjare dhe aktivitete ditore për fëmijët në situatë rruge;
- IV. Projekte që ndikojnë në fuqizimin e shkathtësive prindërore dhe funksionimin familjar, me qëllim mbrojtjen e fëmijës dhe plotësimin e nevojave të familjes në funksionimin e pavarur të familjes;
- V. Edukimi, vetëdijesimi, informimi i të miturve lidhur me bazën ligjore për bashkëjetesën, martesën, edukimin seksual, shëndetin riprodhues, planifikimin familjar dhe shëndetin higjienik personal;
- VI. Projekte që janë të orientuara për përkrahje të fëmijëve, të miturve me sjellje asociale dhe delikuentet e mitur dhe familjeve të tyre, Projektet duhet përfshijnë shërbime, aktivitete psiko-sociale, programe edukative, bashkëpunim ndërinstytucional në përkrahjen dhe mbështetjen e tyre në tejkalimin e sfidave dhe zbatimin e masave të diversitetit.
- VII. Projekte që nxisin autonominë profesionale dhe riintegrimin e tyre në jetën socio - ekonomike, me theks të veçantë prindërit vetushqyes.

4.0. Për të moshuarit projektet duhet të jenë të dizajnuara, të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë tek pjesëtarët e kësaj kategorie. Këto projekte duhet jenë të fokusuara në fushat si në vijim:

- I. Projekte të cilat ofrojnë shërbime psikologjike, sociale, kulturore për të moshuarit në strehim rezidencial dhe atyre në familje apo të vetëm;
- II. Projekte që nxisin pjesëmarrjen e të moshuarave në jetën aktive sociale, bashkëpunimin dhe përfshirjen sociale të të moshuarave;
- III. Projekte që realizojnë një politikë të shkurtër, barometër, vlerësimin dhe matjet e nevojave dhe kërkesave të të moshuarve;
- IV. Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale të stafit dhe hartimit të dokumenteve strategjike për funksionimin e institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit;
- V. Projekte me karakter rekreativ, që përfshijnë organizimin e aktiviteteve që fuqizojnë këtë kategori;
- VI. Projekte që përfshijnë mbështetje në aspektin e shëndetit fizik e mendor për këtë kategori;
- VII. Projekte që ofrojnë shërbime në shtëpi për të moshuarit nëpërmjet njësive mobile.
- VIII.

5.0. Për komunitetet jo shumicë, të gjitha projektet duhet të jenë të dizajnuara që të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë tek pjesëtarët e kësaj kategorie. Këto projekte duhet të jenë të fokusuara në fushat si në vijim:

- I. Projekte që merren me çështje të edukimit, integritit, socializimit dhe fuqizimit të komuniteteve në sferën personale e familjare dhe sociale;
- II. Projekte që merren me aftësimin dhe riaftësimin profesional;
- III. Projekte që nxisin përfshirjen në jetën aktive shoqërore.

6.0. Për personat LGBTQIA+ të gjitha projektet duhet të jenë të dizajnuara që të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë. Projektet duhet të jenë të fokusuara në fushat, si në vijim:

- I. Projekte që ofrojnë mbështetje psiko-sociale;
- II. Aktivitete që ndikojnë në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve dhe aktorëve lokalë për ofrim të shërbimeve sipas nevojave, dhe përmbushjen e të drejtave dhe respektimin e tyre;

- III. Projekte që merren me aftësimin profesional dhe përfshirjen sociale;
- IV. Projekte që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës të kësaj kategorie.

7.0. Për abuzuesit e substancave narkotike, të gjitha projektet duhet të jenë të dizajnuara që të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë tek pjesëtarët e kësaj kategorie. Këto projekte duhet jenë të fokusuar në fushat, si në vijim:

- I. Projekte që për qëllim kanë ofrimin e shërbimeve të nevojshme psiko - sociale dhe me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjen e personave nga abuzimi me substanca narkotike;
- II. Projekte që kanë për qëllim identifikimin dhe referimin e përdoruesve potencialë të substancave narkotike me shërbimet e nevojshme.

8.0. Për familjet me sfida dhe kushte të rënda socio-ekonomike. Projektet duhet të jenë të dizajnuara të garantojnë ndikim të drejtpërdrejtë tek anëtarët, fëmijët apo familjet e. Këto projekte duhet jenë të fokusuar në fushat si në vijim:

- I. Programe që merren me fuqizimin e vajzave, grave/prindërve vetushqyese/lehonave/viktimave të dhunës për kujdes dhe plotësim të nevojave individuale, familjare dhe krijimin e pavarësisë ekonomike dhe sociale;
- II. Projekte që merren me fuqizimin e relacioneve familjare dhe ndër familjare.;
- III. Zhvillimin e shkathtësive prindërore për kujdes të duhur ndaj fëmijëve, përkrahjen e tyre në nevojat edukativo arsimore, për mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre;
- IV. Projekte që merren me përfshirjen sociale në jetën komunitare;

Projekte që merren me aftësimin dhe riaftësimin profesional të individëve, anëtarë të familjes.

9.0. Për veteranët dhe invalidët e luftës. Projektet duhet të jenë të dizajnuara që synim kanë integrimin dhe mbështetjen e tyre në shoqëri dhe të fokusuar në fushat si në vijim:

- I. Projekte që merren me rehabilitimin dhe këshillat socio-fizike;
- II. Projekte që merren me aktivitete rekreative, kulturore dhe sociale;
- III. Projekte që merren me ndihmë dhe përkrahje psiko-sociale.

1. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 400,000.00€ (katërqind mijë euro).

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **500 € (pesëqind euro)** ndërsa shuma maksimale për një projekt është **16,000.00 € (gjashtëmbëdhjetë mijë euro).**

2. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, gjegjësisht nga dt. **08.4.2024 deri me datën 30.4.2024.**
3. OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt në kuadër të kësaj thirrjeje. Periudha e zbatimit të projektit është nga 8 deri 12 muaj.
4. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të (Organizata joqeveritare) që janë të regjistruara sipas dispozitave ligjore për regjistrimin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, dhe të cilat veprojnë në Komunën e Prishtinës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën mbrojtjes së grupeve të rrezikuara dhe në nevojë sociale:
5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me udhëzimet për aplikues, janë në dispozicion për shkarkim në faqen e internetit në linkun në vijim: <https://prishtinaonline.com/drejtore/mireqenia-sociale/subvencionet>
6. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

Komuna e Prishtinës,

Drejtoria e Mirëqenies

Sociale,

rr, UÇK, nr. 2, 10000,

Prishtinë

Qendra për shërbime me

qytetarë,

Kati përdhes, sporteli nr. 3.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në *Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.*

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

7. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: premtim.fazliu@rks-gov.net dhe munavere.qerkezi@rks-gov.net